

Dialogu Ndërkomunitar- Mënyrë e përafrimit të komuniteteve në rajonin e Mitrovicës.



Dialogu Ndërkomunitar 2, Daikonie, Mitrovica e Jugut 29.01.2025

Në një kohë kur sfidat e ndarjes etnike dhe mungesa e besimit vazhdojnë të ndikojnë në jetën e përditshme të qytetarëve në Kosovë, dialogu konstruktiv midis komuniteteve është një mjet i fuqishëm për të ndërtuar ura bashkëpunimi dhe për të krijuar një të ardhme më gjithëpërfshirëse. Në kuadër të projektit “*E ardhmja e Kohësive*” të konsorciumit Syri i Vizionit, Instituti Edutask dhe NGO Aktiv, që financohet nga Global Community Engagement and Resilience Fund (GCERF) po aplikohet një qasje e re e ndërveprimit në mes të komuniteteve duke përfshirë udhëheqës të fshatrave, lagjeve dhe komuniteteve si dhe përfaqësues të institucioneve dhe shoqërisë civile për të ndërmarrë hapa konkret drejt bashkëpunimit.

Në takim të mbajtur sot në Mitrovicë në qendrën rinore Diakonie, të organizuar nga Instituti Edutask dhe NGO Aktiv, pjesëmarrësit nga komuniteti shqiptar dhe ai serb nga komuna e Mitrovicës jugore, Mitrovicës veriore, Zveçanit, Zubin Potokut e Leposaviqit, si vazhdim i diskutimit të sfidave të përbashkëta propozuan ide konkrete bashkëpunimi. Idetë e propozuara ishin nga fusha e kulturës, sportit, ekonomisë, dhe jetës së përditshme, ide që do të përpunohen në vazhdimësi nga projekti së bashku me komunitetet. Kjo qasje dialogu po demonstroi që përtej ndasive etnike, ekziston një interes i përbashkët për të ndërtuar një shoqëri më të hapur dhe më funksionale. Dialogu aplikoi parimin e dëgjimit aktiv, duke krijuar hapësirë për të gjithë pjesëmarrësit që të shprehin shqetësimet dhe pritshmëritë e tyre. Përmes këtij procesi, projekti ka kontribuar në rritjen e besimit dhe respektit të ndërsjellë dhe ofrimin e propozimeve konkrete dhe zgjidhjeve praktike për sfidat e komuniteteve.

Si takimi i dytë ndër-komunitar pas një serie të shtatë dialogjeve fillimisht brenda shtatë komunave pjesëmarrëse në projekt dhe trajnimeve dhe udhëzimeve për rritjen e ndikimit të figurave të rëndësishme të komuniteteve në parandalimin e ekstremizmit dhe promovimin e bashkëjetesës dhe bashkëpunimit, elementi kyç është vazhdimësia e angazhimit i cili ka mundur një qasje gjithëpërfshirëse që angazhon të gjitha grupet e shoqërisë. Ky angazhim i vazhdueshëm kërkon vullnet, durim dhe bashkëpunim të ndërsjellë. Për këtë arsye, projekti synon të krijojë një proces të qëndrueshëm dialogu i cili do të mbështesë aktivitetet e ardhshme të propozuara nga komunitetet.